

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,** Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe sekretaren juridike Minire Krasniqi, në çështjen juridike të inicuar me padinë e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson [REDACTED] avokate nga Ferizaj, kundër të paditurve: [REDACTED] nga Ferizaj, Rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komua Viti, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Viti, të cilët me autorizim i përfaqëson [REDACTED] avokat nga Viti, dhe [REDACTED] nga Shkupi, Maqedonia, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, në seancën e mbajtur më datën 01.10.2018 ka marr dhe publikuar këtë:

### A K T G J Y K I M

*– në bazë të pohimit –*

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj, e ushtruar kundër të paditurve: [REDACTED] nga Ferizaj, [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komua Viti, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Viti dhe [REDACTED] nga Shkupi, Maqedonia, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, në bazë të parashkrimit fitues.

**II. VËRTETOHET** se paditësi [REDACTED] është pronar i parcelave kadastrale si në vijim: parcela nr. **696-1** në sipërsaqe prej 11049 m<sup>2</sup>, parcela nr. **696-2** në sipërsaqe prej 1353 m<sup>2</sup>, parcela nr. **696-3** në sipërsaqe prej 11049 m<sup>2</sup>, parcela nr. **696-4** në sipërsaqe prej 2867 m<sup>2</sup>, parcela nr. **1387-0** në sipërsaqe prej 6194 m<sup>2</sup>, parcela nr. **1388-0** në sipërsaqe prej 6595 m<sup>2</sup>, parcela nr. **1389** në sipërsaqe prej 1249 m<sup>2</sup>, parcela nr. **1390** në sipërsaqe prej 1089 m<sup>2</sup>, parcela nr. **00081-0** në sipërsaqe prej 11551 m<sup>2</sup>, si dhe 1/12 e pjesës ideale të parcelave: nr. **660-1** në sipërsaqe prej 7022 m<sup>2</sup> dhe parcela nr. **660-2** në sipërsaqe prej 5171 m<sup>2</sup>, të gjitha me kulturë “arë”, të evidentuara në Certifikatën e njësisë kadastrale nr.131496/17 dhe Certifikatën P-72217082-01389-0, Zona Kadastrale Sojevë, Komuna Ferizaj, sipas përshkrimit të ekspertizës së datës 08.08.2018 të punuar nga eksperti i gjeodezisë gjeo. [REDACTED]

**III. DETYROHEN** të paditurit [REDACTED] nga Ferizaj, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komua Viti, [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Viti dhe [REDACTED] nga Shkupi, Maqedonia, që paditësit t’ia pranojë të drejtën e pronësisë dhe t’al lejojnë regjistrimin e të njejtës në regjistrat kadastral, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me forcë.

**IV.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

## A r s y e t i m i

Paditësi në padi dhe në precizim të padisë, ka theksuar se pronën objekt kontesti e ka blerë nga të paditurit, gjegjësisht nga paraardhësit e të paditurve, në vitin 1966-67, dhe atë, parcelat si në vijim: parcelën nr. 696-1 në sipërsaqe prej 11049 m<sup>2</sup>, parcelën nr. 696-2 në sipërsaqe prej 1353 m<sup>2</sup>, parcelën nr. 696-3 në sipërsaqe prej 11049 m<sup>2</sup>, parcelën nr. 696-4 në sipërsaqe prej 2867 m<sup>2</sup>, parcelën nr. 1387-0 në sipërsaqe prej 6194 m<sup>2</sup>, parcelën nr. 1388-0 në sipërsaqe prej 6595 m<sup>2</sup>, parcelën nr. 1389 në sipërsaqe prej 1249 m<sup>2</sup>, parcelën nr. 1390 në sipërsaqe prej 1089 m<sup>2</sup>, parcelën nr. 00081-0 në sipërsaqe prej 11551 m<sup>2</sup>, si dhe 1/12 e pjesës ideale të parcelave: nr. 660-1 në sipërsaqe prej 7022 m<sup>2</sup> dhe parcelën nr. 660-2 në sipërsaqe prej 5171 m<sup>2</sup>, të gjitha me kulturë "arë", të evidentuara në Certifikatën e njësisë kadastrale nr. 131496/17 dhe Certifikatën P-72217082-01389-0, Zona Kadastrale Sojevë, Komuna Ferizaj, sipas përshkrimit të ekspertizës së datës 08.08.2018 të punuar nga eksperti i gjeodezisë gjeo. [REDACTED]

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, gjatë seancave dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetemi në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe pranë precizimit të padisë e rregullimit të padisë, duke theksuar se pronën kontestuese e ka blerë nga paraardhësit e të paditurve në vitin 1967 me marrëveshje gojore ndërsa një pjesë tjetër të pronës kontestuese e ka blerë në vitin 1981, me ç'rast, paditësi u'a kishte paguar në tërësi të paditurve çmimin e shitblerjes dhe meqenëse e kishte përbushur marrëveshjen në lidhje me këtë shitëblerje (e kishte paguar çmimin e kontraktuar) kishte hyrë në posedim të pronës menjëherë në vitin 1967, përkatësisht në vitin 198 dhe që nga atëherë e deri me tani, e ka poseduar dhe shfrytëzuar me mirëbesim, pa u penguar apo kontestuar nga askush, andaj mendoj se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që parashihen përfitimin e drejtës së pronësisë në bazë të marrëveshjes gojore të shitblerjes dhe mbajtjes e shfrytëzimit në mirëbesim të pronës përmë tepër se 40 vite, prandaj i propozoj gjykatës që padinë e paditësit ta aprovoj si të bazuar me ligj dhe të bie aktgjykim me të cilin i njihet e drejta pronësore paditësit në pronën objekt i këtij kontesti.

I padituri [REDACTED] deklaroit se nuk e konteston padinë dhe as kërkesëpadinë e precizuar të paditësit dhe i propozon gjykatës të njejtën ta aprovojë si të bazuar, duke nxjerrë aktgjykim në bazë të pohimit.

I autorizuari i të paditurve [REDACTED] dhe [REDACTED] deklaroit se nuk e kundërshton padinë e as kërkesëpadinë e paditësit [REDACTED], ndaj të paditurve [REDACTED] dhe [REDACTED], lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi parcelat kontestuese dhe atë për pjesët ideale nga 1/8 të të paditurve të lartëcekur.

I paditurit [REDACTED] ne seancën dt. 22.05.2018 ka deklaruar se nuk ka interest juridik përkitazi me parcelat objekt kontesti.

Eksperti i gjeodezisë, gjeo. [REDACTED], pas daljes dhe këqyrjes në vend, ka përpiluar raportin me shkrim të datës 08.08.2018, në të cilin ka dekluaruar se: prona kontestuese gjendet në Z.K. Sojevë, K. Ferizaj, e përbërë nga njësitë kadastrale – parcelat si në vijim: parcela Nr. 696-1 në sipërfaqe prej 11049 m<sup>2</sup>, parcelën Nr. 696-2 në sipërfaqe prej 1353 m<sup>2</sup>, parcelën Nr. 696-3 në sipërfaqe prej 11049 m<sup>2</sup>, parcelën Nr. 696-4 në sipërfaqe prej 2867 m<sup>2</sup>, parcelën Nr. 1387-0 në sipërfaqe prej 6194 m<sup>2</sup>, parcelën Nr. 1388-0 në sipërfaqe prej 6595 m<sup>2</sup>, parcelën Nr. 1389 në sipërfaqe prej 1249 m<sup>2</sup>, parcelën Nr. 1390 në sipërfaqe prej 1089 m<sup>2</sup>, parcelën Nr. 00081-0 në sipërfaqe prej 11551 m<sup>2</sup>, të gjitha këto me 1/1 të pjesës ideale të pronësisë, si dhe parcelat në vijim: parcela Nr. 660-1 dhe parcela Nr. 660-2 në sipërfaqe të tërësishme prej 1000 m<sup>2</sup>, këto dy parcela me 1/12 të pjesës ideale të pronësisë, të cilat parcela shtrihen dhe kufizohen në fillim nga rruga publike e fshatit në gjatësi prej 14.77 m, e cila shkon në brendësi të ngastrës në thellësi prej 48.94 m, përgjatë rrugës së fshatit në gjerësi të ngastrës në gjatësi prej 24.43 m, pastaj vazhdon të shtrihet në kufi me ngastrën kadastrale nr. 662-1 në gjatësi prej 40.56 m, të gjitha të evidentuara në Certifikatën e njësisë kadastrale nr. 131496/17 dhe Certifikatën P-72217082-01389-0 Zona Kadastrale Sojevë, Komuna Kadastrale Ferizaj, të evidentuar në emër të të paditurve.

Gjkata, me qëllim të vërtetimit plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për aq sa palët ndërgjygjëse përm bushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar provat dhe faktet e çështjes, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, Gjkata ka bërë administrimin e tyre me si vijon: *mendimi i ekspertit të gjeodezisë [REDACTED] së bashku me raportin përshkrues, skicën e matjeve si dhe certifikatën e pronësisë.*

Gjkata, pasi bëri shqyrtimin dhe analizimin e provave të qështjes, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka bërë vlerësimin e tyre veç e veç dhe të ndërlidhura mes veti, si tërësi, dhe mbi bazën e bindjes së lirë të krijuar mbi bazën e fakteve dhe provave të çështjes, ka vlerësuar se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga deklarimi i palëve ndërgjygjëse, dëshmitarëve dhe provave të administruara në këtë procedurë, Gjkata vërtetoi këtë gjendje faktike: se paditësi [REDACTED] e ka blerë pronën kontestuese nga paraardhësit e të paditurve në vitin 1967 përkatësisht në vitin 1981 në bazë të marrëveshjes gojore, e ka paguar çmimin e shitblerjes dhe nga ajo kohë e deri me tanë e ka poseduar në mënyre të pa ndërprerë dhe të papenguar nga skush për më tepër se 40 vite.

Gjkata nga konstatimi i gjendjes faktike, vërtetoi posedimin dhe shfrytëzimin me mirëbesim të pronës kontestuese për më shumë se 40 vite dhe mbi këtë bazë paditësi e fiton të drejtën e pronësisë mbi pronën kontestuese.

Prandaj, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve dhe provavës materiale, të cilat u elaboruan më lartë, Gjkata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në tërësi dhe e njejta duhet të aprovohet.


Nga të lartë cekurat, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, bazuar në nenin 28 të Ligji për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore dhe nenit 148 të LPK-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës Gjykata ka vendlodhi në bazë të nenin 450 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**C.nr.67/18, me datë 01.10.2018**



Gjyqtari,  
Enes Mehmeti



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLICA E KOSOVËS  REPUBLICA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNO-SNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më \_\_\_\_\_ 27.10.2018  
Dana \_\_\_\_\_ 20.18

